

Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm
(KOSID)

Hesapi i Rrymës

Prishtinë, gusht 2013



Botuar nga GAP, INDEP dhe FIQ në kuadër të KOSID

Përgatitur nga:

Dren Pozhegu (Instituti GAP)

Krenar Gashi (Instituti për Politika Zhvillimore - INDEP)

Kushtrim Puka (Forumi për Iniciativa Qyetare - FIQ)

Copyright © 2013 GAP, INDEP dhe FIQ

1. Hyrje

Çmimet e energjisë elektrike në Kosovë janë rritur disa herë gjatë dekadës së fundit. Vetëm në vitin 2012, faturat e qytetarëve të Kosovës për energji janë rritur për 8.9%. Ky trend i shtrenjtimit nuk korrepondon me trendin e zhvillimit ekonomik të vendit. Sipas indikacioneve preliminare, çmimet e energjisë do të vazhdojnë të rriten edhe gjatë viteve në vijim, duke e vështirësuar edhe më tej përballueshmërinë e energjisë elektrike nga qytetaret.

Për të adresuar këtë shqetësim të qytetarëve, Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID) do të ndërmarrë një seri studimesh të shkurta politike, përmes së cilave synohet që të ndikohet në politika publike në Kosovë dhe të ofrohen zgjidhje për përballueshmërinë e çmimeve të larta të energjisë elektrike nga ekonomitë familjare.

Qeveria e Kosovës vazhdimisht ka aluduar se çmimet në Kosovë janë shumë të ulëta dhe se rritjen e tyre nuk mund ta ndalin. KOSID konsideron se është obligim i institucioneve të vendit, që përmes politikave publike t'ua mundësojë qytetarëve të kenë qasje në energji elektrike dhe të mund ta paguajnë atë.

Në këtë studim të parë, KOSID do të analizojë arsyet prapa rritjes së çmimeve si dhe shpenzimet e energjisë elektrike në Kosovë. Do të shpjegojmë se cilët faktorë e kanë mbajtur çmimin e energjisë elektrike të ulët deri tani, sa do të kushtojë në të ardhmen, kush e harxhon energjinë elektrike në Kosovë dhe kur harxhohet kjo energji. Më pas, do të shohim masat e efijencës së energjisë dhe do të mundohemi të analizojmë se sa do të jenë faturat e energjisë elektrike të përballueshme për qytetarët e Kosovës.

2. Sa ka kushtuar rryma?

Prej periudhës së pasluftës, Kosovarët kanë paguar çmim relativisht të ulët për energjinë elektrike. Në vitin 2011, çmimi mesatar i energjisë elektrike në Kosovë, pa taksa, sipas Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), ishte 5.78 euro cent për KWh. Krahasuar me vendet tjera të rajonit, Kosova paguan më shumë për KWh sesa Maqedonia dhe Serbia, më pak se Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Mali i Zi. Ndërsa krahasuar me 27 vendete e Bashkimit Evropian, të cilët paguajnë një mesatare prej 14.16 euro cent, Kosova paguan rreth tri herë më pak.




Figura 1 - Krahasimi i çmimeve të energjisë elektrike, pa taksa, për ekonomitë familjare. Burimet: ZRRE, Eurostat dhe Agjencia e Energjisë e Serbisë.

Megjithatë, ky çmim i energjisë elektrike në Kosovë, nuk ka qenë real por virtual, kryesisht për shkak të mosllogaritjeve të kostos së prodhimit dhe subvencioneve të mëdha që Qeveria e Kosovës i ka dhënë KEK-ut. Kostoja reale e energjisë është edhe më e madhe nëse në të llogariten rreth 1 miliard euro të cilat donatorë të ndryshëm i kanë investuar në KEK që nga viti 1999¹, investime të cilat nuk llogariten në çmim në formë të investimit dhe të zhvlerësimit të aseteve të investuara.

Sipas KEK-ut, prodhimi i një MWh energji elektrike në Kosovë ka kushtuar rreth 25 euro, që i bie 2.5 euro cent për kWh.² Sipas kësaj logjike, edhe çmimet që konsumatorët i kanë paguar, duke llogaritur këtu koston e transimit dhe shpërndarjes, duket të kenë qenë proporcionale me çmimin e prodhimit. Megjithatë, ky çmim i prodhimit ka qenë krejtësisht virtual. Pikë së pari, në këtë çmim nuk është llogaritur eksploatimi i linjitet sipas çmimeve të tregut rajonal apo evropian.³ Meqë KEK-u, si kompani publike, kishte një lloj monopoli në shfrytëzimin e burimeve natyrore si linjiti, asnjëherë nuk është llogaritur kostoja e vërtetë e këtij eksploatimi.

¹ Lavdim Hamidi, Loja me rrymë pengon zhvillimin e Kosovës, BIRN, 2008, <http://fellowship.birn.eu.com/en/fellowship-programme/topic-2%C3%A5C3%A58-power-struggle-loja-me-rryme-pengon-zhvillimin-e-kosoves>

² Raportet vjetore të KEK-ut mes viteve 2008-2011 si dhe deklaratat e shumta të zyrtarëve të KEK-ut dhe MZHE-së.

³ Shih Opsionet e Qëndrueshme për Energji në Kosovë, raport i Laboratorit për Energji të Ripërtitshme të Universitetit të Kalifornisë – Berkeley, <http://rael.berkeley.edu/kosovoenergy>

Teknologjia e vjetër e gjenerimit përmes të cilës prodhohet rreth 98% e energjisë elektrike në Kosovë bën që në koston e prodhimit të mos llogaritet zhvlerësimi i aseteve. Po ashtu, aseteve që kanë hyrë në KEK si donacion nuk u llogaritet fare zhvlerësimi.

Në zbritjen virtuale të çmimit ka ndikuar edhe mos llogaritja e koston së djegies së linjtit dhe dëmit që ky proces ia shkakton mjedisit dhe shoqërisë. Kësisoj, në këtë çmim të prodhimit, e sipas tij edhe në çmimin e inkasimit të energjisë, nuk është llogaritur asnjë investim i Qeverisë në KEK. Së dyti, sipas studimeve të Bankës Botërore, për çdo vit rreth 835 qytetarë të Kosovës vdesin hershëm, si pasojë e ndotjes së ajrit⁴. Ndotësit më të mëdhenj të ajrit në Kosovë janë pikërisht termocentralet që djegin linjit. Meqë KEK-u si korporatë publike nuk ka dhënë kurrfarë përgjegjësie sociale për dëmin e shkaktuar nga operacionet e gjenerimit të energjisë, në çmimin e gjenerimit nuk është llogaritur asnjë nga kostot e jashtme të prodhimit. Kësisoj, çmimi ka qenë shumë më i lartë sesa që është paraqitur.

Nëse çmimi i energjisë paska qenë shumë më i lartë sesa ai që i është faturuar qytetarit, pyetja logjike që pason është kush e ka paguar pjesën tjetër të faturës? Pos dëmit të drejtpërdrejtë në mjedis dhe në shoqëri, qytetarët e Kosovës kanë paguar pjesën tjetër të faturave përmes taksave të tyre që i vjel Qeveria. Vetëm gjatë viteve 2009-2011, KEK-ut i janë lejuar rreth 146 milionë euro të hyra nga subvencionet e qeverisë⁵. Politika e subvencioneve nuk ka ardhur vetëm nga Qeveria e Kosovës dhe donatorët e ndryshëm, por edhe nga vetë ZRRE-ja. Çmimi për energjinë elektrike për amvisni është 'nder-subvencionuar' nga çmimi i energjisë elektrike për operator komercial.⁶ Ky ndër-subvencionim nënkupton që çmimi për operator komercial ka qenë më i fryrë ndërsa ai për amvisni ka qenë më i ulët. Ani pse kjo konsiderohet si pjesë e politikës publike për ta bërë çmimin e rrymës më të përballueshëm për qytetarët, një rritje e tillë ka ndikuar që shërbimet dhe prodhimet e operatorëve komercial të kenë çmime më të larta, çmime këto të cilat sërish u janë faturuar qytetarëve. Njëkohësisht, çmimet më të larta për operatorët komercial gjithashtu ndikojnë në vështirësimin e zhvillimit të sektorit privat në Kosovë.

⁴ World Bank – Kosovo CEA (Country Environmental Analysis)
<http://siteresources.worldbank.org/INTKOSOVO/Resources/KosovoCEA.pdf>

⁵ Raportet vjetore të ZRRE-së, 2009-2011.

⁶ Ibid

3. Pse do të rriten çmimet?

Me privatizimin e sektorit energjetik në Kosovë, çmimet e energjisë elektrike priten të rriten edhe më tej. Një kalkulim i vrazhdë i KOSID-it tregon se në vitin 2016, faturat e energjisë elektrike do të jenë shumëfish më të larta se faturat e vitit 2011.⁷

Pikë së pari, subvencionet e Qeverisë për KEK-un pritet të eliminohen plotësisht deri në vitin 2015. Pas privatizimit, me ndërtime të kapaciteteve të reja gjeneruese, çfarëdo qofshin ato, kostoja e zhvlerësimit të aseteve do përbëjë një pjesë më të madhe të faturës e cila do t'u ngarkohet qytetarëve. Në të njëjtën kohë, si rezultat i rritjes së vetëdijes qytetare për dëmet anësore të gjenerimit të energjisë, qofshin ato mjedisore apo shëndetësore, si dhe për shkak të obligimeve për respektimin e direktivave Evropiane, kapacitetet gjeneruese do të obligohen të investojnë si duhet në masat mbrojtëse. Këtu hyjnë zvogëlimi i emetimeve të gazrave toksike, kontrollimi i ndotjes së ajrit, tokës dhe ujit, menaxhimi i duhur i mbetjeve të gjenerimit si dhe masat tjera mbrojtëse sipas standardeve Evropiane. Këto ndryshime do të bëjnë që çmimi i faturave të energjisë elektrike të shkojë drejt reflektimit të kostos reale të kësaj energjie, që nënkupton rritjen e çmimeve të energjisë elektrike.

Përpos reflektimit të kostos së përgjithshme të prodhimit, çmimi i energjisë elektrike pritet të rritet edhe më tej si rrjedhojë e liberalizimit të tregut, obligim ky që del nga Traktati i Komunitetit të Energjisë të cilin Kosova e ka nënshkruar në vitin 2005.⁸ Kësisoj, çmimi i energjisë elektrike do të jetë përafërsisht i barazuar në të gjithë rajonin. Kosovarët, meqë deri më tani kanë paguar fatura relativisht më të ulëta sesa qytetarët e vendeve të rajonit, do të ballafaqohen me një rritje të mëtejme të çmimeve në momentin kur ndodhë liberalizimi.

KOSID e përkrahë fuqishëm tregun e lirë në sektorin e energjisë, meqë, në shumicën e vendeve, liberalizimi i tregut lejon që çmimi i energjisë të përcaktohet nga relacioni mes kërkesës dhe ofertës. Megjithatë, me dy projektet e mëdha të privatizimit të sektorit të energjisë, Qeveria e Kosovës nuk e ka përgatitur terrenin për një konkurrencë të mirëfilltë në sektorin e energjisë. Shitja e rrjetit shpërndarës dhe të furnizimit tek një kompani e vetme, e cila më vonë pritet të ketë konkurrencë në furnizim teksa do ta mbajë monopolin e rrjetit, nuk paraqet premisë të shëndoshë për një treg të lirë. Për më shumë, për shkak të çmimeve virtuale të cilat u elaboruan më lartë, liberalizimi në Kosovë nuk do të sjellë çmime më të ulëta, siç bën zakonisht, por vetëm se do t'i rrisë ato.

⁷ Kosovo needs clean energy – not new coal (Kosova ka nevojë për energji të pastër, jo për më shumë thëngjill)
<http://kosid.org/wp-content/uploads/2012/09/Facts-on-New-Kosovo-Power-Plant-May-2012.pdf>

⁸ The Energy Community Treaty (Traktati i Komunitetit të Energjisë)
http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/127074_en.htm

4. Përballimi i çmimeve të energjisë

Të gjitha statistikat tregojnë se rreth 40% e forcës punëtore në Kosovë është e papunë⁹, ndërsa sipas Bankës Botërore, 16% e popullatës jeton në varfëri të skajshme me më pak se 1 dollar amerikan në ditë.¹⁰ Në dekadën e fundit, rritja ekonomike në Kosovë, e cila matet si rritje e Bruto Produktit Vendor (BPV), në pesë vitet e fundit ka qenë rreth 6%¹¹. Megjithëse kjo mesatare e përqindjes do të ishte shumë e kënaqshme për vendet e zhvilluara, për Kosovën me 1.8 milionë banorë që prodhon gjithsejtë 6.7 miliardë dollarë amerikan në vit, nuk do të thotë shumë.¹² Kjo rritje ekonomike e Kosovës, ani pse e vogël, nuk varet shumë nga industrinë e prodhimit. Tre faktorët më të rëndësishëm të rritjes ekonomike janë: investimet e sektorit publik të cilat përbëjnë 12% të BPV-së, remitancat nga diaspora (14% e BPV-së), dhe ndihma financiare nga donatorët e ndryshëm (7.5% e BPV-së). Asnjë nga këta tre faktorë nuk kanë bazë të qëndrueshmërisë së rritjes ekonomike dhe zhvillimit social.

Për shkak të mungesës së një strategjie të mirëfilltë për zhvillim të qëndrueshëm, faturat e energjisë elektrike do të vazhdojnë të jenë barrë e rëndësishme e qytetarëve të Kosovës. Në vitin 2011, një familje kosovare ka shpenzuar hiç më shumë se 1,210 euro në vit, apo rreth 100 euro në muaj, për energji elektrike.¹³ Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rreth 38% të shpenzimeve të një familje kosovare shkojnë në ushqim, ndërsa rreth 31% në kostot e banimit, pjesë kryesore e të cilës kosto është fatura e energjisë. Ky fenomen tregon se rritja e njëjës nga këto kategori shpenzimesh, do të ndikonte në mënyrë substanciale në shportën familjare. Pra, rritja e çmimit të energjisë elektrike do të ndikojë rrënjësisht në mirëqenien e qytetarëve.

Papërballueshmëria e çmimeve të energjisë mund të ndikojë në një artikulum më të qartë për të gjitha pakënaqësitë tjera sociale. Pakënaqësi të tilla vetëm sa janë shprehur në forma të protestave të cilat zgjaten disa javë rresht me rastin e ‘fryrjes’ së faturave të energjisë elektrike në janar të vitit 2013.¹⁴ Në të ardhmen, kjo mund të ndikojë në zgjerimin e pakënaqësive tjera sociale e politike në Kosovë.

⁹ Të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë 2011, <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/>

¹⁰ Të dhënat e Bankës Botërore, <http://databank.worldbank.org/data/views/reports/tableview.aspx>

¹¹ IMF – 2011 Article IV Consultation Report for the Republic of Kosovo

¹² Ibid

¹³ Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare, Agjencia e Statistikave të Kosovës, http://esk.rks-gov.net/konsumi-i-ekonomive-familjare/publikimet/doc_view/1007-rezultatet-e-anketes-se-buxhetit-te-ekonomive-familjare-2012?tmpl=component&format=raw

¹⁴ Ndale Hajninë – Zhvilloje Shtetin, portali Koha, <http://koha.net/?page=1.13.138387>

5. Kush e shpenzon rrymën?

Si vend në zhvillim, Kosova nuk ka sektor të zhvilluar të industrisë. Kësisoj, për dallim nga vendet e zhvilluara, shumica e energjisë elektrike në Kosovë shpenzohet nga ekonomitë familjare. Sipas të dhënave të ZRRE-së, rreth 55% të energjisë elektrike në Kosovë, shpenzohet për çështje amvisërie, 25% për nevoja të industrisë dhe 17% për sektorin komercial. Rreth 3% llogaritet të jenë shpenzimet e vet KEK-ut për miniera dhe distribucion.




Figura 2 – Pjesëmarrja e kategorive të konsumit të përgjithshëm 2011. Burimi: ZRRE, Raporti Vjetor 2011.

Kjo përqindje e lartë e shpenzimeve të energjisë elektrike nga ekonomitë familjare dhe për çështje të amvisërisë, nuk është përcjellë me rregullimin e politikës publike për eficiency të energjisë. Një studim i mëhershëm i INDEP ka kritikuar Ligjin për Eficiency të Energjisë në Kosovë, i cili ligj rregullon vetëm sektorin publik por jo edhe atë privat sa i përket masave eficiency. ¹⁵ Po ashtu, Ligji për Ndërtim, nuk parasheh ndonjë kriter të caktuar për eficiency të energjisë. Pra, legjislacioni në Kosovë, nuk e rregullon sektorin në të cilin shpenzohet më shumë se gjysma e gjithë energjisë elektrike. Për t'u përgjigjur qartë në pyetjen e kësaj pjese të punimit, rrymën në Kosovë e shpenzojnë më shumë ekonomitë familjare dhe më pak industria.

¹⁵ Eficiency e Energjisë në Kosovë, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), http://indep.info/documents/15763_INDEP%20-%20Eficiency%20e%20Energjise%20ne%20Kosove.pdf

6. Kur po shpenzohet rryma?

Siç tregojnë të dhënat e ZRRE-së në figurën e mëposhtme, konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike në Kosovë varion mes 300GWh dhe 630GWh për muaj. Ky dallim kaq i madh mes shpenzimeve, sipas të njëjtit burim është dallim sezonal, ku shpenzimet gjatë dimrit janë më shumë se dy herë më të mëdha sesa gjatë verës.




Figura 3 – Konsumi i energjisë elektrike sipas muajve dhe sezonave mes vitit 2009 dhe 2012. Burimi: Raportet vjetore të ZRRE-së 2009-2012.

Edhe ngarkesa e energjisë elektrike, e cila matet me MW, dallon shumë mes sezonës së dimrit dhe verës. Siç tregon edhe figura 4, në vijim, e kalkuluar nga KOSID dhe Sierra Club sipas të dhënave të ZRRE-së dhe KOST-it, në Kosovë ngarkesa gjatë sezonit të dimrit varion më së shumti prej 600MW deri në 1200MW, ndërsa verës, prej 350MW deri në 750MW.




Figura 4 – Ngarkesa e energjisë elektrike në Kosovë në bazë të orëve dhe muajve.


Siç tregojnë të dy këto krahasime, të shpenzimeve dhe ngarkesës, kosovarët shpenzojnë shumë më shumë energji elektrike gjatë sezonit të dimrit, sesa gjatë verës. Kjo ndodhë për shkak të dy arsyeve. E para, gjatë sezonit të dimrit ditët janë më të shkurta dhe netët më të gjata që ndikon drejtpërdrejt në rritjen e konsumit të energjisë për ndriçim. Megjithatë, sasia e energjisë që përdoret për ndriçim është shumë e vogël në krahasim me shpenzimet e përgjithshme. Kësisoj, arsyeja e dytë, ngrohja e hapësirave përmes energjisë elektrike, është faktori kyç që ndikon në këtë variacion. Një kalkulim preliminar i bazuar në të dhënat për konsumin e energjisë elektrike në baza mujore, mund të themi që rreth 22% e energjisë elektrike të injektuar në rrjetin e shpërndarjes përdoret për ngrohje. Kjo shifër është shumë e lartë nëse krahasohet, për shembull, me SHBA-të, ku vetëm 6% e energjisë elektrike përdoret për ngrohje.¹⁶ Menaxhimi i këtij fenomeni do të ndikonte dukshëm në konsumin e energjisë elektrike e me këtë edhe në faturat e saj.

¹⁶ http://www.eia.gov/energyexplained/index.cfm?page=electricity_use

7. Ngrohja dhe efiçienca termike

Meqë shumica e energjisë elektrike në Kosovë shpenzohet nga ekonomitë familjare dhe një pjesë e mirë e kësaj energjie shpenzohet për ngrohje, është me rëndësi të dihet efiçienca termike e hapësirave të banimit. Sipas një studimi të Universitetit Amerikan në Kosovë dhe Institutit të Roçesterit për Teknologji (Rochester Institute of Technology), botuar në mars të vitit 2013, shumica absolute e hapësirave të banimit në Kosovë, nuk kanë kurrfarë izolimi termik.¹⁷

Sipas anketës së bërë nga AUK-RIT, në pyetjen nëse shtëpitë e tyre kanë izolim të çative/kulmeve, 64% të respondentëve janë përgjigjur negativisht, 33% pozitivisht ndërsa 3% nuk e kanë ditur. Në pyetjen rreth posedimit të dritareve me xham të dyfishtë nëpër hapësirat e tyre të banimit, 46% të respondentëve janë përgjigjur pozitivisht, 53% negativisht, ndërsa 1% nuk janë përgjigjur në këtë pyetje.



Të dhënat nga ky studim gjithashtu na tregojnë se 48.1% e poqeve elektrike të përdorura janë të llojit inkandeshent (jo-efiqente). Sa i përket izolimit të mureve, 70% të mureve të hapësirave të banimit në Kosovë kanë dalë të jenë të pa izoluara, 26% të izoluara ndërsa 4% nuk kanë pasur përgjigje në këtë pyetje. Të dhënat e kësaj ankete janë pothuajse tërësisht të kundërta me vendet Evropiane. Në Britani të Madhe, për shembull, rreth 66% e shtëpive kanë izolim të kulmit dhe rreth 69% e tyre kanë izolim të mureve¹⁸. Izolimi i hapësirave të banimit në Kosovë, pra, është në shkallën më të ulët sa i përket vendeve të Evropës Kontinentale.

¹⁷ Kosovo Household Energy Consumption: Facts and Figures (Shpenzimet e energjisë elektrike në ekonomitë familjare në Kosovë: faktet dhe figurat), AUK-RIT Center for Energy & Natural Resources, March 2013

¹⁸ Estimates of Home Insulation Levels in Great Britain (Nivelet e Izolimit të Shtëpive në Britaninë e Madhe (Dhjetor 2012) Departamenti për Energji dhe Ndryshime Klimatike. Department of Energy and Climate Change

8. Përfundime

Në këtë analizë të shkurtër, kemi treguar se faturat e energjisë elektrike në Kosovë kanë qenë virtualisht të ulëta. Qytetarët, çmimin e plotë të energjisë elektrike e kanë paguar përmes faturave të KEK-ut por edhe përmes taksave, mjedisit dhe shëndetit të tyre. Kjo ka ndikuar, deri në një masë, që të krijohet përshtypja se energjia elektrike është e lirë dhe se përfaqëson një ndër mënyrat më të lira për të ngrohur hapësirat e banimit. Kësisoj, kosovarët harxhojnë shumë më shumë rrymë gjatë dimrit sesa gjatë verës.

Meqë është krijuar përshtypja se energjia elektrike është e lirë, nuk ka pasur hapësirë për incentiva investuese në efikasitet të energjisë. Kësisoj, hapësirat e banimit që gjatë dimrit ngrohen edhe përmes energjisë elektrike, nuk janë efikente, duke e rritur edhe më shumë konsumin e përgjithshëm të energjisë. Me fjalë tjera, një sasi e konsiderueshme e energjisë së shpenzuar për ngrohje humbet si pasojë e mungesës së izolimeve të mureve, xhamave dhe çatave.

Trendi i çmimeve të energjisë, siç kemi treguar, është në rritje. Me privatizimin e ngutshëm dhe jo adekuat të sektorit të energjisë si dhe për shkak të mos përgatitjes së Kosovës për liberalizim të tregut të energjisë, këto çmime do të rriten edhe më tej. Ekonomitë familjare në Kosovë, do të kenë vështirësi të mëdha për t'i përballuar këto rritje çmimesh. Qeveria e Kosovës, duhet të gjejë zgjidhje, përmes politikave publike në sektorin e energjisë, që t'ua mundësojë qytetarëve këtë përballim.

Meqë ekonomitë familjare janë shpenzuesit më të mëdhenj të energjisë elektrike në Kosovë, për dallim prej vendeve tjera ku industria shpenzon më shumë rrymë, fokus i politikave qeveritare duhet të jetë efikasiteti e energjisë në këtë sektor. Deri më tani, asnjë politikë publike nuk është përqendruar për të rregulluar sektorin e ekonomive familjare.

Për më shumë, në Kosovë nuk ka asnjë masë stimuluese për përdorimin e mënyrave alterantive për ngrohje, gjë që do të zvogëlonte në masë të konsiderueshme kërkesën për energji.

Meqë çmimet do të rriten edhe më tej, ndërsa zhvillimi ekonomik i Kosovës nuk është në të njëjtin hap me rritjen e çmimeve, KOSID i rekomandon Qeverisë së Kosovës që t'i ndihmojë qytetarët t'i ulin shpenzimet e panevojshme të energjisë elektrike, në mënyrë që faturat e ekonomive familjare të jenë të përballueshme për ta.

Për këtë qëllim, KOSID do të zhvillojë kërkime tjera të politikave publike, ku efikasiteti në sektorin e ekonomive familje do të jetë në fokus të studimit. KOSID do të rekomandojë ndryshime konkrete të politikave, duke përfshirë këtu masat stimuluese dhe ato ndëshkuese, në mënyrë që qytetarët e Kosovës të mund t'u bëjnë ballë faturave të energjisë elektrike.



Themeluar më 2011 si shoqatë e analistëve të politikave, hulumtuesve dhe aktivistëve të shoqërisë civile, INDEP fokusohet në politikat zhvillimore, duke ofruar një vizion përmbajtësor për integrimet Euro-Atlantike. Në Kosovë, ku edhe vepron, INDEP ka në fokus të veçantë forcimin e qeverisjes demokratike dhe luan rolin e mbikëqyrësit të politikave publike.



Instituti për Studime të Avancuara GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtite në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtite në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.



Forumi për Iniciativa Qytetare (FIQ), është organizatë joqeveritare me fokus në Filantropi, Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Sektorin e Sigurisë. FIQ, poashtu përkrahë projekte për qytetari aktive dhe mbrojtje të ambientit, përmes Programit të Granteve. FIQ është themeluar në vitin 2000, nga një grup i vogël njerëzish, të cilët kanë parë nevojën e aktivizimit të qytetarëve në proceset vendim-marrëse, si pasojë e luftës së Kosovës, në periudhën 1998-1999.

Nga të qënit organizatë e koncentruar në çështjet e sigurisë dhe aktivizimit qytetar, nga formimi i saj, FIQ, me qëllim për të forcuar rolin e qytetarëve, ka rritur fushat e veprimit edhe në programe tjera si grantdhënia, filantropia dhe zhvillimi i qëndrueshëm.